



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

Lindita Fazliu  
Drejtoreshë  
TV Vali  
T022  
Gjilan

Vendimi LIC: 2008/03  
Ref: 0806/0828/CIMC/mi

**VENDIM**

*lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të TV Valit*

---

**Fakte**

1. Parashtruesi i kërkesës është subjekt transmetues privat në Gjilan. TV Vali ka pranuar licencën e modifikuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media më 5 janar 2006 i cili sipas kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së është i licencuar që të transmetoj nga lokacioni Maja e Gjelbër.
2. Më 15 maj 2008, Komisioni i Pavarur për Media ka pranuar një kërkesë nga TV Valit lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, për të kaluar në një pikë tjetër të transmetimit afër pikës aktuale të licencuar brenda Majës së Gjelbër, në një distancë prej përafërsisht rreth 100 metra.
3. TV Vali kërkon që ta ndërrojë lokacionin e sistemit të transmetimit për arsye se deri më tani ka transmetuar nga shtylla e transmetimit të një subjekti tjetër transmetues, për shfrytëzimin e të cilit TV Vali ka paguar qira dhe shpeshherë ka hasur në pengesa për qasje tek ajo pikë transmetimi për zgjidhjen e problemeve rreth transmetimit.
4. Për këtë arsye TV Vali ka ndërtuar një pikë të re të transmetimit që është pronë e tij përmes së cilës TV Vali do të kursejë mjete të konsiderueshme financiare dhe do të ketë fleksibilitet në zgjidhjen e problemeve të transmetimit të TV Valit.

**Arsyetimi**

5. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komisioni i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
6. Sipas vlerësimit të inxhinierit të Departamentit të Menaxhimit të Frekuencor (DMF) të KPM-së, të bërë më 11 qershor 2008, në bazë të analizës përmes programit softuerik

1      Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031    f. +381 (0)38 245 034    e. info@imc-ko.org

ATDI ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit të TV Valit, duke në lokacionin e propozuar në koordinatat gjeografike N 42° 32289" ; dhe E 21° 29203 nuk do të ketë ndryshime në zonën e mbulimit të TV Vali-t dhe nuk paraqet ndryshime të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së KPM-së.


7. Prandaj, DMF vlerëson se kalimi i TV Valit në vendin e propozuar me anë të kërkesës dhe transmetimi nga ajo pikë është në pajtim me Kushtet dhe Termet e Licencës së KPM-së.
8. Arsyetimi nga ana e parashtruesit të kërkesës është i mjaftueshëm për Këshillin e KPM-në që ta aprovojë kërkesën për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit nga ana e TV Vali-t.
9. Këshilli i KPM-së në pajtim me vlerësimet e lartpërmendura nxjerr këtë:

#### Vendim

10. Këshilli i KPM-se pajtohet me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të TV Valit duke kaluar me transmetim sipas koordinatave të përcaktuara me këtë vendim.
11. Këshilli i KPM-së konkludon se me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit nuk do të ketë ndryshime theksueshme të Pjesës 2 dhe 4 të licencës së TV Valit.
12. Këshilli i KPM-së miraton ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të TV Valit, përkohësisht deri në fazën e ri-licencimit.

#### Lëshimi i Vendimit


13. Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim.

  
Argjentina Grazhdani  
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

16/06/2008  
datë

#### Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

  
Nalle Selimaj Krasniqi  
Shefe Ekzekutive e KPM-së



16.06.2008  
datë